



BASHKIA
TIRANË

URDHËR

Nr. 79729, datë 09.08. 2017

PËR KONTROLLIN E SUBJEKTEVE QË USHTROJNË AKTIVITETIN E TYRE TË TREGTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNGSHËM, TË NAFTËS PËR AUTOMJETE, VAJRAVE LUBRIFIKANTE DHE LËNDËVE DJEGËSE, PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 29, pika 4, nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 8, pika 1 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës" (i ndryshuar); ligjit nr. 8450, datë 24.02.01999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre (i ndryshuar); vendimit nr. 970, datë 2.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" (i ndryshuar),

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave për kontrollin e çdo subjekti që ushtron aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.
2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, strukturat përkatëse të Bashkisë së Tiranës, në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, si edhe me çdo strukturë tjetër përgjegjëse dhe mbështetëse, marrin masat për bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.
3. Në rastet e bllokimit të aktivitetit për shkak të ushtrimit të veprimtarisë pa licencë, subjekti qëndron i bllokuar deri në momentin e pajisjes me licencën përkatëse për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion VELIAJ

